



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës, Vushtrri

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe të nenit 55 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 30.06.2011 mori këtë:

## **V E N D I M**

Për emërimin e anëtarëve shtesë të Komitetit për Komunitete

### **Neni 1.**

Me këtë Vendim emërohen anëtarët shtesë të Komitetit për Komunitete, siç vijon:

1. Bratislav Kostiq;
2. Milan Kostiq.

### **Neni 2**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

### **Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---



Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinim të mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës nga projekti nr.14 në listën e projekteve kapitale të vitit 2011 "Blegtori, Pemëtari dhe Perimkulturë" në shumë prej 7.000 €, ridestinohe në projektin nr.15 "Rregullimi i bankinave të Lumit Sitnica" në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, dhe në bazë të marrëveshjes për bashkëfinancim në mes të MTPT dhe Komunës së Vushtrrisë, nr.792-1/10, dhe nr. 1022/10 të datës 22/09/10, gjegjësisht nenit 3, paragrafit 3.1. të kësaj marrëveshje, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinim të mjeteve buxhetore të komunës.

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës nga projekti nr.16 në listën e projekteve kapitale të vitit 2011 rr. "Dëshmorët e Kombit" në shumë prej 100.000 € ridestinohen në projektin "Ndërtimi i rrugës Strofc-Bequk-Mihaliq".

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim, Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, dhe në bazë të marrëveshjes për bashkëfinancim në mes të MTPT dhe Komunës së Vushtrrisë, nr.792-2/10, të datës 22/09/10, gjegjësisht nenit 1, paragrafit 1.2, nënpika 1 të kësaj marrëveshje, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinim të mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet e lira buxhetore të mbetura nga realizimi i projekteve kapitalet të vitit 2011 të komunës në shumë prej 128.480 € ridestinohen në projektin “Ndërtimi i rrugës Ashlan-lagjja Bahtiri-fabrika e ujit-Akrashticë”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---



Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për Kornizën Afatmesme Buxhetore

Neni 1

Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2012-2014.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr 37<sup>2</sup>/11 të datës 24.02.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të Organizatës së Veteranëve të luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri, në shumën prej 5.000 €, për shënimin e ditës së formimit të Brigadës së UÇK-së – Zona Operative e Shalës.

**Neni 2**

Obligohet Dreitoria për Shëndetsi dhe Përkujdesje Sociale që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve, i cili do të hartoj raport për mjetet e shpenzuara në shumën e cekur si në nenin paraprak.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për transferin e mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetor të komunës nga programet buxhetore të mjeteve të lira buxhetore të projekteve kapitale në shumë prej 58,000.00€ të transferohen nga këto programe buxhetore:

**a) Nga Drejtoria e Administratës, kodi i programit 163**

- Projekti, Renovimi objektit të komunës, kodi ekonomik (83122), shuma 25,000.00 €,
- Orendi për zyre në administratën e komunës, kodi ekonomik (83119), shuma 3,000.00€, dhe

**Nga Drejtoria për Planifikim urban dhe mjedis, kodi i programit 660**

- Mbikëqyrja e projekteve, kodi ekonomik (83136), shuma 20,000.00€.

**Nga Drejtoria për Kulturë rini dhe sport, kodi i programit (850)**

- Restaurimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit, kodi ekonomik (83147), shuma 10,000.00€.

**b) Këto mjete transferohen në mallra dhe shërbime në këto programe buxhetore:**

- Administrata dhe personeli kodi i nën programit (16324), shuma 4,115.63 €,
- Shërbime publike, mbrojtje civile dhe emergjencë kodi i nën programit (18024), shuma 35,746.63€,
- Inspeksion kodi i programit (166), shuma 10,548.00€,
- Zyra e Komuniteteve kodi i programit (195), shuma 3,646.73€,
- Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural, kodi i nën programit (47024), shuma 3,942.95€.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 11 dhe 12 "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dhe petitionit të banorëve të fshatit Begaj, të datës 20.05.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

#### V E N D I M

##### Neni 1

Autorizohet Kryetari i Komunës që të formon një komision profesional për të konstatuar gjendjen faktike në varrezat e qytetit në fshatin Begaj, dhe i njëjti komision duhet t'i raporton Kuvendit të Komunës në seancën e muajit korrik.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Sekretaria e Kryetarit.

##### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinim të mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës nga projekti “Rregullimi i kanalizimeve” në shumë prej 25.000 € ridestinohej: 20.000 € në projektin “Furnizimi me gypa të kanalizimit” dhe 5.000 € në projektin “Rregullimi i rrugëve të rendit të IV-të”

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI



Bazuar në nenin 11, 12.1 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenin 40 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011 mori këtë:

V E N D I M

Për anulimin e vendimit të KK-së për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së pa luajtshme të komunës

Neni 1

Anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.218/10, dt.30.09.2010, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim, të pronës së paluajtshme të komunës, z. Kreshnik Bashollit pronar i Sh. P. K. “Betimi” me seli në Vushtrri, pjesa e parces kadastrale 8-412, fletë poseduese nr. 198 (12/287), në sipërfaqe prej 70 ari, ZK Stanoc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr.37<sup>2</sup>/11 të datës 24.02.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të OJQ "Çeshme" në Vushtri, në shumën prej 3.500 € (tre mijë e pesëqind euro), për udhëtim dhe pjesëmarrje në një festival në Turqi.

**Neni 2**

Obligohet Dreitoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve, i cili do të hartoj raport për mjetet e shpenzuara në shumën e cekur si në nenin paraprak.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI

---

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenin 41 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës, në shumë prej 3.000. € (tremijë euro) për realizim të projektit “rregullimi i rrugës Vesekoc – Skromë” financim i përbashkët me OJQ “Vicianarural” me seli në Vushtrri.

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike që në emër të Komunës së Vushtrrisë të nënshkruajnë marrëveshjen në fjalë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës si dhe duke iu referuar rekomandimit të USAID-it/DEMI, iniciativa për komuna demokratike dhe efektive, dt. 07 qershor 2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2011, mori këtë:

V E N D I M

PËR REALIZIM TË PROJEKTEVE NGA MJETET E FONDIT TE USAID-it /DEMI PËR KOMUNA  
DEMOKRATIKE DHE EFEKTIVE

Neni 1

Nga fondi i USAID-it/DEMI iniciativa për komuna demokratike dhe efektive për v. 2011, mjetet e fondit në shumë prej 25.000 \$, ose 17.250. €, destinohen për realizim të projekteve të komunës si në vijim:

- Rregullimi i parkut te banesat e bardha - Rr. "Skenderbeu" .....7.000 €
- Rregullimi i parkut të qytetit (ulëset dhe fontana) ..... 6.000 €
- Shporta për hedhurina në rrugët e qytetit ..... 4.250 €

=====

GJITHSEJTË :..... 17.250 €.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**